

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektiligj “Për urdhërin e Agronomit”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	1. Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për Miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”; 2. Vendim nr. 366, datë 16.6.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027”; 3. Programi Qeverisës 2025-2029
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	06.02.2025 deri me 06.03.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	25/8/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 1/6/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 - MBZHR- Nr.2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj <i>e-mail-i:</i> Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402 Eneida Sokoli <i>e-mail-i:</i> Eneida.Sokoli@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0695612584 Valdete Buca <i>e-mail-i:</i> Valdete.buca@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0693937433
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	

Politika e propozuar synon të adresojë mungesën e një kuadri ligjor dhe institucional të konsoliduar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të agronomit në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, ushtrimi i këtij profesioni nuk mbështetet në një strukturë të posaçme publike apo profesionale që të garantojë kritere të qarta për kualifikimin, rregulla për sjelljen profesionale dhe mekanizma përgjegjësie dhe disipline.

Kjo situatë ka sjellë që profesioni i agronomit të ushtrohet në mënyrë të pakoordinuar me institucionet publike përgjegjëse për politikave bujqësore dhe mjedisore, si dhe me strukturat këshilluese dhe kontrolluese të sektorit, duke rezultuar në ofrim të shërbimeve teknike pa rregulla të qarta cilësie dhe pa mekanizma efektivë kontrolli dhe përgjegjësie, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në:

- cilësinë e shërbimeve këshilluese që u ofrohen fermerëve dhe operatorëve të sektorit,
- zbatimin e qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm të politikave bujqësore dhe mjedisore,
- besimin e publikut dhe institucioneve ndaj profesionit të agronomit.

Shkaqet kryesore të identifikuara të këtij problemi janë:

- mungesa e një kuadri ligjor që rregullon ushtrimin e profesionit të agronomit si profesion me funksion publik dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore, mjedisin dhe zhvillimin territorial;
- mungesa e një enti publik profesional që të ofrojë vetërregullim, mbikëqyrje, kontroll disiplinor dhe promovim të formimit profesional të vazhdueshëm;
- mungesa e mbrojtjes ligjore të titullit profesional “Agronom”, çka krijon konfuzion profesional dhe cenon standardet e ushtrimit të profesionit.

Si pasojë, profesioni i agronomit nuk shfrytëzohet plotësisht në funksion të politikave publike bujqësore, ndërkohë që në të njëjtën kohë ushtrimi i tij zhvillohet në mungesë të mekanizmave të qartë të kontrollit dhe mbikëqyrjes, pavarësisht rëndësisë së drejtpërdrejtë që ka për rritjen e produktivitetit bujqësor, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme, pasi profesioni i agronomit ushtron funksion publik dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në interesa themelore publike, përfshirë:

- sigurinë dhe cilësinë e prodhimit ushqimor,
- mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin territorial,
- zbatimin e politikave kombëtare dhe angazhimeve ndaj Bashkimit Europian.

Në mungesë të ndërhyrjes shtetërore, tregu i shërbimeve profesionale agronomike nuk arrin të vetërregullohet në mënyrë efektive, duke krijuar rreziqe për cilësinë, përgjegjshmërinë dhe besueshmërinë e shërbimeve teknike. Për këtë arsye, ndërhyrja e qeverisë synon krijimin e Urdhrit të Agronomëve si ent publik profesional, i cili do të vendosë mekanizma të qartë për:

- rregullimin e aksesit në profesion mbi bazën e kualifikimit dhe aftësisë profesionale,
- mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit,
- zbatimin e standardeve etike dhe sistemeve disiplinore,
- promovimin e formimit dhe ricertifikimit profesional.

Propozimi për këtë politikë të rë është në përputhje me praktikat më të mira evropiane për profesionet e rregulluara dhe synon jo kufizimin, por forcimin institucional dhe shoqëror të profesionit të agronomit, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Grupet e ndikuar janë:

- Agronomët
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Fermerët
- Operatorët ekonomike në sektorin bujqësor
- Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore
- Konsumatorët

Nëpërmjet kësaj nisme synohet rregullimi dhe orientimi i ushtrimit të profesionit të agronomit përmes vendosjes së një kuadri të qartë ligjor dhe institucional, i cili forcon përgjegjësinë profesionale, rrit rolin shoqëror të agronomit dhe siguron ushtrimin e profesionit në funksion të interesit publik. Krijimi i Urdhrit të Agronomëve synon të sigurojë kontroll, mbikëqyrje dhe vetërregullim profesional, duke mundësuar shfrytëzimin e plotë të potencialit të agronomëve në zbatimin e politikave bujqësore, rritjen e produktivitetit, garantimin e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të ngrihen dhe të bëhen funksionale 100% e organeve drejtuese dhe disiplinore të Urdhrit të Agronomëve, sipas përcaktimeve të ligjit.
2. Brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, të regjistrohen në regjistrin profesional të Urdhrit të Agronomëve të paktën 90% e agronomëve që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.
3. Brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, të reduktohet me të paktën 80% numri i rasteve të identifikuara të ushtrimit të profesionit nga persona të paregjistruar në Urdhrin e Agronomëve.
4. Të zhvillohen jo më pak se 4 aktivitete formimi profesional në vit dhe të përfshihen në to të paktën 50% e agronomëve të regjistruar, me qëllim përmirësimin e standardeve profesionale dhe etike të ushtrimit të profesionit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së (mosndërrhyrja)

Ruajtja e gjendjes aktuale, pa ndërmarrë nisma ligjore për rregullimin e ushtrimit të profesionit të agronomit, nënkupton mosadresimin e problematikave të evidentuara në lidhje me ushtrimin e pakontrolluar të profesionit, mungesën e mekanizmave të mbikëqyrjes, përgjegjësisë dhe etikës profesionale. Ky opsion nuk krijon asnjë përmirësim në mënyrën e ushtrimit të profesionit dhe nuk mundëson shfrytëzimin e plotë të rolit të agronomit në mbështetje të politikave bujqësore, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit rural, duke ruajtur të pandryshuar situatën ekzistuese.

Opsioni 1 – (rregullator) Miratimi i një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit (opsioni i preferuar)

Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri të posaçëm, që rregullon ushtrimin e profesionit të agronomit përmes krijimit të Urdhrit të Agronomëve, si ent publik profesional. Duke qenë se nuk ekziston një ligj i mëparshëm që rregullon këtë profesion, ky opsion ofron një zgjidhje të plotë dhe të drejtpërdrejtë të problematikave të konstatuara, duke vendosur për herë të parë:

- rregulla të qarta për aksesin dhe ushtrimin e profesionit;
- mekanizma mbikëqyrjeje, etike dhe disiplinore;
- përgjegjësi profesionale dhe ricertifikim periodik;
- rol të strukturuar të agronomit në shërbim të interesit publik.

Ky opsion është në përputhje me praktikatat evropiane për profesionet me funksion publik dhe krijon bazën ligjore të nevojshme për forcimin institucional të profesionit të agronomit.

Opsioni 2 – (rregullator) Rregullimi i pjesshëm përmes legjislacionit ekzistues sektorial

Ky opsion do të konsistonte në përfshirjen e dispozitave për agronomin në ligje të tjera sektoriale ekzistuese (p.sh. ligje për bujqësinë, zhvillimin rural apo sigurinë ushqimore). Megjithatë, ky opsion nuk ofron një rregullim të plotë dhe koherent të profesionit, pasi fragmenton rregullimin ligjor, nuk krijon një mekanizëm vetërregullues profesional dhe nuk garanton mbikëqyrje të vazhdueshme etike dhe disiplinore. Si i tillë, ky opsion nuk siguron zgjidhje afatgjatë dhe nuk adreson në mënyrë të qëndrueshme problematikën e identifikuar.

Opsioni 3 – (jorregullator) Përmirësimi i praktikave administrative dhe zbatimit në terren

Ky opsion parashikon forcimin e praktikave administrative ekzistuese, përmes trajnimeve, orientimeve teknike dhe rritjes së monitorimit nga institucionet publike përgjegjëse. Megjithëse mund të sjellë përmirësime të kufizuara në afat të shkurtër, ky opsion nuk zgjidh problemin themelor të mungesës së rregullimit ligjor të profesionit, nuk krijon detyrime të qarta për ushtrimin e profesionit dhe nuk garanton kontroll profesional të qëndrueshëm. Për rrjedhojë, ky opsion mbetet joefektiv për adresimin e plotë të problematikës.

Përfundimisht, Opsioni 1 është zgjedhur duke analizuar opsionet e mësipërme, opsioni i miratimit të një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit përbën opsionin më të përshtatshëm dhe efektiv, pasi adreson në mënyrë të plotë dhe të strukturuar problematikën ekzistuese, krijon një kuadër të qartë ligjor dhe institucional dhe siguron ushtrimin e profesionit të agronomit në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është *Opsioni 1 (rregullator)*: Miratimi i ndryshimeve ligjore ofron kuadrin ligjor rregullator për krijimin e Urdhrit të Agronomit duke siguruar që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet europiane.

Grupet e prekura:

a) Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Agronomët

- Vendosje e rregullave të qarta për ushtrimin e profesionit dhe mbrojtje e titullit profesional.
- Rritje e përgjegjësisë dhe etikës profesionale në ushtrimin e veprimtarisë.
- Forcim i rolit dhe identitetit profesional në raport me institucionet dhe shoqërinë

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Krijim i një mekanizmi të strukturuar vetërregullimi profesional jashtë administratës publike.
- Përmirësim i koordinimit me profesionistët në zbatimin e politikave bujqësore.
- Rritje e efikasitetit të mbikëqyrjes së ushtrimit të profesionit.

3. Fermerët

- Përmirësim i cilësisë dhe besueshmërisë së shërbimeve këshilluese teknike.
- Qartësi më e madhe mbi përgjegjësinë profesionale të agronomit.
- Ulje e rrezikut nga këshillimi jo profesional ose i paautorizuar.

4. Operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor

- Siguri më e madhe profesionale në bashkëpunimin me agronomët.
- Standardizim i praktikave teknike në marrëdhëniet profesionale.
- Mbështetje më e strukturuar për zbatimin e kërkesave teknike dhe rregullatore.

5. Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore

- Lehtësim i zbatimit të politikave sektoriale përmes mbështetjes profesionale të organizuar.
- Përmirësim i koordinimit ndërinstitutional në terren.
- Rritje e besueshmërisë së kontributit teknik profesional në vendimmarrje.

6. Konsumatorët

- Përfitim indirekt nga rritja e cilësisë dhe sigurisë së prodhimit bujqësor.
- Kontribut në mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

- Rritje e besimit publik në zinxhirin ushqimor dhe shërbimet profesionale.

b) Ndikimet Kryesore të Projektligjit “Për Urdhrin e Agronomit”

1. Ndikime Sociale

- Forcimi i rolit shoqëror të agronomit si profesion me funksion publik dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë ndaj interesit të përgjithshëm.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve profesionale në zonat rurale, duke kontribuar në mbështetjen e fermerëve dhe komuniteteve rurale.
- Rritja e besimit të publikut të profesionistët që ofrojnë shërbime teknike në fushën e bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit.

2. Ndikime Ekonomike

- Përmirësimi i efikasitetit të vendimmarrjes teknike në aktivitetet bujqësore përmes ushtrimit të kontrolluar dhe të përgjegjshëm të profesionit.
- Ulja e rreziqeve që lidhen me këshillimin jo profesional, duke ndikuar pozitivisht në produktivitetin bujqësor.
- Krijimi i kushteve të qëndrueshme për zhvillimin profesional të agronomëve dhe për cilësi më të lartë në shërbimet e ofruara.

3. Ndikime Mjedisore

- Përmirësimi i zbatimit të praktikave të mira bujqësore në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.
- Mbështetje më e strukturuar profesionale për politikën mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

c) Kosto dhe Përfitime sipas Grupeve të Prekura

1. Agronomët

Kosto:

- Detyrime për anëtarësim, respektim të rregullave profesionale, etikës dhe ricertifikimit.

Përfitime:

- Mbrojtje ligjore e profesionit dhe licensim për titullin profesional.
- Rritje e statusit, besueshmërisë dhe sigurisë profesionale.
- Ushtrim i profesionit në një mjedis të rregulluar dhe të mbrojtur.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Kosto:

- Angazhim fillestar institucional për ngritjen dhe mbështetjen e Urdhrit.

Përfitime:

- Delegim i vetërregullimit profesional të një entit të specializuar.
- Përmirësim i zbatimit të politikave bujqësore dhe zhvillimore.
- Reduktim i barrës administrative afatgjatë.

3. Fermerët

Kosto:

- Përshtatje me shërbime profesionale më të strukturuar.

Përfitime:

- Rritje e cilësisë dhe përgjegjësisë së shërbimeve këshilluese.
- Siguri më e madhe në vendimet teknike që ndikojnë prodhimin.

- Mbështetje më e besueshme dhe e qëndrueshme profesionale.

4. Operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor

Kosto:

- Përshtatje me kërkesa profesionale më të standardizuara.

Përfitime:

- Qartësi në marrëdhëniet profesionale me agronomët.
- Ulje e rrezikut nga shërbime jo profesionale.
- Përmirësim i planifikimit dhe kontrollit teknik.

5. Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore

Kosto:

- Nevojë për koordinim institucional me Urdhrin e Agronomëve.

Përfitime:

- Mbështetje teknike profesionale më e organizuar.
- Zbatim më efektiv i politikave sektoriale.
- Përmirësim i kontrollit dhe monitorimit në terren.

6. Konsumatorët

Kosto:

- Nuk identifikohen kosto direkte.

Përfitime:

- Përfitim indirekt nga përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore.
- Rritje e besimit në zinxhirin ushqimor dhe mbrojtjen e mjedisit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kriterë e kryer për të tre opsionet tregoi se **Opsioni 1**, hartimi i projektaktit “Për urdhërin e Agronomit” është vlerësuar me më shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si opsionin e preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

Opsioni 2--(rregullator)- Opsioni i preferuar, miratimi i një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit, është zgjedhur si alternativa më e përshtatshme dhe më efektive për ndërhyrjen publike, pasi adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshme problematikat e identifikuar në ushtrimin e profesionit të agronomit, të cilat nuk mund të zgjidhen përmes masave të pjesshme apo ndërhyrjeve jo-rregullatore.

Në fazën e analizës së opsioneve, u vlerësua se ruajtja e status quo-së do të çonte në vazhdimin e një situatë ku profesioni i agronomit ushtrohet pa orientim të strukturuar, pa mekanizma të qartë përgjegjësie dhe pa mbikëqyrje profesionale, duke mos garantuar mbrojtjen e interesit publik në sektorë me ndjeshmëri të lartë, si bujqësia, siguria ushqimore dhe mbrojtja e mjedisit. Ky opsion nuk krijon asnjë ndryshim real dhe nuk i përgjigjet nevojës për rritjen e rolit dhe kontributit të agronomëve në politikat publike.

Po ashtu, opsionet jo-rregullatore, të bazuara kryesisht në forcimin e praktikave administrative, trajnime apo udhëzime të brendshme, u vlerësuan si të pamjaftueshme,

pasi nuk krijojnë detyrime ligjore për ushtrimin e profesionit, nuk vendosin kritere të detyrueshme për aksesin në profesion dhe nuk mundësojnë kontroll të qëndrueshëm etik dhe disiplinor. Këto masa, edhe nëse zbatohen, kanë efekt të kufizuar dhe të paqëndrueshëm në kohë.

Në mungesë të një ligji të posaçëm që rregullon profesionin e agronomit, ndërhyrjet përmes legjislacionit ekzistues sektorial do të rezultojnë të fragmentuara dhe jo koherente, duke mos krijuar një sistem të integruar vetërregullimi profesional dhe duke mos i garantuar profesionit statusin dhe mbrojtjen e nevojshme që buron nga funksioni i tij publik.

Për këto arsye, miratimi i një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit përbën opsionin e vetëm që:

1. vendos një kuadër të plotë dhe të qartë për ushtrimin e profesionit;
2. krijon një ent publik profesional të specializuar për vetërregullimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e profesionit;
3. siguron balancën ndërmjet autonomisë profesionale dhe mbrojtjes së interesit publik;
4. harmonizon qasjen kombëtare me praktikën evropiane për profesionet e rregulluara me funksion publike.

Kostot e identifikuar për këtë opsion janë të kufizuara në kohë dhe të përqendruara kryesisht në fazën fillestare të zbatimit, konkretisht në vitin e parë dhe, nëse është e nevojshme, edhe në vitin e dytë. Këto kosto lidhen drejtpërdrejt me buxhetimin e funksionimit të Urdhrit të Agronomëve si ent publik profesional, dhe përfshijnë:

- shpenzime për ngritjen fillestare të strukturave administrative dhe organizative;
- shpenzime për personelin administrativ dhe mbështetës;
- shpenzime për funksionimin e organeve drejtuese dhe disiplinore;
- shpenzime operative bazë për ushtrimin e veprimtarisë institucionale.

Këto shpenzime parashikohen të mbulohen nga buxheti i shtetit vetëm në fazën fillestare, duke qenë se Urdhri, si ent publik jobuxhetor, do të kalojë gradualisht në vetëfinansim përmes kontributeve dhe tarifave të anëtarëve.

KONSTULTIMI

Metodat e përdorura gjatë Konsultimit Publik janë:

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë **4.6.2026** dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, ku të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;

- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe

personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, shin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte **2.7.2026**. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 304 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP, por vetëm në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për Urdhrin e Agronomit në Republikën e Shqipërisë”, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (4.6.2026 – 2.7.2026);
- Marrja e mendimeve nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, si proces i bashkrendimit të projektligjit nëpërmjet sistemit *e-akte* dhe komunikimeve elektronike.
- Tryezë publike me SHASH (Shoqatën e Agronomëve Shqipëtarë), e zhvilluar në datën 27.7.2026 dhe komentet e përcjella nëpërmjet email-it. Diskutimet dhe komentet e paraqitura nga ana e SHASH janë si vijon:

1.SHASH komentoj lidhur me Regjistrinë Elektronike: “Të sqarohet se çfarë do të përfshijë regjistri elektronik. Duke qenë se në relacion parashikohet një fond prej 25 milionë lekësh për krijimin e tij, është e nevojshme të përcaktohet funksionaliteti dhe përmbajtja e regjistrisë. Gjithashtu, propozojmë të shqyrtohet mundësia e njëhimit të Dëshmisë së Aftësisë me NIPT-in e fermerit, me qëllim lehtësimin e punës së agronomit gjatë ushtrimit të profesionit në përditshmëri.

Lidhur me këtë koment pas diskutimeve dhe sqarimeve nga ana e përfaqësuesve të MBZHR u dakortësua që funksionimi, përmbajtja dhe elementët thelbësorë të regjistrisë elektronike do të rregullohen në Statutin e Urdhrit.

2. SHASH komentoj lidhur me pikën 4, të Nenit 4 të projektligjit:” "Kategoritë të cilët ushtrojnë veprimtari profesionale të lidhura me atë të agronomit nuk anëtarësohen në Urdhrin e Agronomit. Ata regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe gjatë ushtrimit të profesionit të tyre ata i nënshtrohen rregullave sipas përcaktimeve në Statut." Propozojmë të përcaktohen qartë se cilat janë "profesionet e lidhura me agronominë", pasi projektligji nuk i specifikon dhe kjo mund të krijojë paqartësi në zbatim. Lidhur me këtë koment pas diskutimeve dhe sqarimeve nga ana e përfaqësuesve të MBZHR u dakortësua që përcaktimi i profesioneve të lidhura me agronominë do të bëhet në Statutin e Urdhrit.

3.SHASH komentoj lidhur me diplomat:” Projektligji flet për "diplomë universitare përkatëse", por nuk përcakton se cilat diploma japin të drejtën e regjistrimit në Urdhrin e Agronomit:”Propozojmë të përcaktohen qartë diplomat që njihen, si p.sh.:Bachelor; Master; Mbrojtje Bimësh; Hortikulturë , etj”

Lidhur me këtë koment pas diskutimeve dhe sqarimeve nga ana e përfaqësuesve të MBZHR u dakortësua se parashikimi në draftligjin është i saktë dhe rregullon në mënyrë shteruese me këtë çështje.

4. SHASH komentoj lidhur me pikën 2, të nenit 9, Kreu II. Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, anëtarët e Urdhrit detyrohen: a) të garantojnë dokumentimin e rekomandimeve teknike që japin, përfshirë përdorimin e inputeve bujqësore; b) të garantojnë gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve agronomike në nivel ferme, parcele apo kulture; c) të mbajnë evidencë të verifikueshme mbi rekomandimet, trajtimet dhe protokollet e zbatuara. Propozojmë të sqarohet mënyra e zbatimit praktik të këtyre detyrimeve. Konkretisht: 1. A do të mbahet një regjistër i vetëm? 2. Do të mbahen dy regjistra të vecantë? Dokumentimi të realizohet në mënyrë elektronike përmes një platforme të dedikuar?

Lidhur me këtë koment pas diskutimeve dhe sqarimeve nga ana e përfaqësuesve të MBZHR u dakortësua mbi mënyrën e zbatimit praktik të detyrimeve që lidhen me dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe mbajtjen e evidencave sipas përcaktimit në draftligj pasi është edhe mënyra e saktë komform kuadrit ligjor në fuqi si edhe sugjerimeve të specialistëve të fushës teknike.

5. SHASH komentoj lidhur me nenin 10, përfaqësimi gjinor. Projektligji parashikon që zgjedhjet në organet drejtuese të sigurojnë përfaqësim në masën 30% për çdo gjini. Propozojmë të sqarohet mënyra e zbatimit të këtij kriteri në rastet kur në një qark apo strukturë nuk arrihet ky raport

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR dhanë sqarime dhe informacion duke arritur dakortësinë me përfaqësuesit e SHASH që dispozita do të riformulohet në një mënyrë më të qartë, duke përdorur një formulim si "**deri në 30%**".

6. SHASH komentoj lidhur me pjesëmarrjen në formimin e strukturave duke propozuar që shoqatat profesionale të agronomëve të kenë përfaqësim në Komisionin e Përkohshëm ose në procesin e ngritjes së strukturave të para të Urdhrit të Agronomit.

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR konfirmuan se Shoqata Shqiptare e Agronomëve do të ketë përfaqësim dhe do të jetë pjesë e grupit të punës për ngritjen e strukturave të para të Urdhrit.

7. SHASH komentoj lidhur me mbrojtjen ligjore e anëtarëve. Propozojmë që Urdhri të ketë detyrimin të mbrojë anëtarët e tij kur kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi si edhe kanë respektuar standardet profesionale;

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR sqaruan se kjo çështje do të rregullohet në Statutin e Urdhrit.

8. SHASH komentoj lidhur me parashikimin e draftligjit mbi financimi nga shteti të Urdhrit duke parashtruar se Projektligji parashikon financim nga shteti vetëm për vitin e parë të funksionimit. Propozojmë që financimi fillestar të zgjasë 2 vite, me qëllim

garantimin e konsolidimit institucional dhe krijimin e një sistemi funksional përpara vetëfinancimit të Urdhrit.

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR sqaruan se mundësitë për financimin do të mbetet i kufizuar vetëm në vitin e parë kjo për të mundësuar ngritjen dhe funksionimit të organizmave të Urdhërit.

9. SHASH komentoj lidhur me provimin e shtetit Projektligji kërkon zhvillimin e provimit të shtetit, por nuk përcakton:

- kush e organizon;
- kur zhvillohet;
- procedurën e zhvillimit;
- mënyrën e vlerësimit.

Propozojmë që këto elemente të përcaktohen qartë në ligj ose në aktet nënligjore.

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR pasi sqaruan dhe informuan për parashikimin e saktë të draftligjit në përputhje edhe me parashikimet e ligjeve të tjera në fuqi në vëndin tonë të cilat rregullojnë këto çështje mes palëve u dakordësua që do të përcaktohen më qartë kategoritë që përfitojnë nga përjashtimi nga provimi i shtetit.

10. SHASH komentoj lidhur me pezullimin nga ushtrimi i profesionit ku sipas tyre Projektligji parashikon pezullimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në 3 vite.

Megjithatë nuk përcakton:

- cilat konsiderohen shkelje të lehta;
- cilat konsiderohen shkelje të rënda;
- kriteret mbi bazën e të cilave vendoset masa disiplinore.

Propozojmë që këto kriteret të përcaktohen qartë.

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR pasi sqaruan dhe informuan përfaqësuesit e SHASH palët u dakordësuan se kriteret dhe procedurat përkatëse do të rregullohen në Statutin e Urdhrit.

11. Lidhur me Gjobat Projektligji parashikon gjoba nga 1 500 deri në 100 000 lekë.

Propozojmë që të përcaktohen kriteret objektive për vendosjen e gjobave, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Projektligji nuk përcakton afatet për:

- regjistrimin;
- shqyrtimin e kërkesave;
- miratimin e regjistrimit;
- pezullimin;
- rikthimin në ushtrimin e profesionit.

Propozojmë që këto afate të përcaktohen qartë, me qëllim garantimin e sigurisë juridike dhe funksionimit efikas të Urdhrit.

U dakordësua që kriteret për vendosjen e gjobave do të përcaktohen në Statutin e Urdhrit. Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR pasi sqaruan dhe informuan përfaqësuesit e SHASH palët u dakordësuan se parashikimet e hollësishme mbi vendosjen e gjobave do të përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

12. SHASH komentoi lidhur me të drejtat e anëtarëve duke u shprehur se projektligji parashikon shumë detyrime për agronomët, por shumë pak të drejta. U Propozua prej tyre që në ligj të përcaktohen shprehimisht të drejtat e anëtarëve, si:

- mbështetja profesionale;
- aksesimi në trajnim;
- informimi periodik;
- pjesëmarrja në vendimmarrje;
- transparenca mbi veprimtarinë e Urdhrit.

Lidhur me këtë koment përfaqësuesit e MBZHR pasi sqaruan dhe informuan përfaqësuesit e SHASH palët u dakordësuan që kjo çështje do të rregullohet në Statutin e Urdhrit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji nga MBZHR dhe organet e vet Urdhërit të Agronomit, si vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Komisioni i Përkohshëm për organizimin e Urdhrit të Agronomëve;
- c) Urdhri i Agronomëve;
- ç) Organet drejtuese qendrore dhe rajonale të Urdhrit të Agronomëve;
- d) Komisionet Disiplinore.-

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron monitorimin e zbatimit të ligjit në kuadër të rolit të saj si autoritet politikëbërës në fushën e bujqësisë dhe si institucion përgjegjës për bashkëpunimin institucional me Urdhërin e Agronomëve. Ministria monitoron funksionimin e përgjithshëm të kuadrit rregullator përmes informimit periodik nga Urdhri mbi anëtarësimet dhe masat disiplinore, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e projektakteve dhe dokumenteve politike në fushën e agronomisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Komisioni i Përkohshëm për organizimin e Urdhrit të Agronomëve i nënshtrohet monitorimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë fazës tranzitore të zbatimit të ligjit. Monitorimi konsiston në verifikimin e përmbushjes së detyrës së tij kryesore, që lidhet me organizimin e zgjedhjeve të para për këshillat rajonale dhe Këshillin Kombëtar të Urdhrit, brenda afatit të përcaktuar në ligj, deri në shpërbërjen e tij me konstituimin e organeve drejtuese.

Urdhri i Agronomëve, si ent publik profesional, është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin e ushtrimit të profesionit të agronomit. Monitorimi realizohet përmes

mbajtjes dhe administrimit të regjistrit profesional, mbikëqyrjes së ushtrimit të profesionit, zbatimit të rregullave të etikës dhe disiplinës profesionale, si dhe përmes zbatimit të procedurave për dhënien, pezullimin ose heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e miratuara nga organet e tij.

Komisionet Disiplinore monitorojnë zbatimin e ligjit nëpërmjet shqyrtimit të ankesave dhe trajtimit të shkeljeve profesionale që lidhen me ushtrimin e profesionit të agronomit. Nëpërmjet procedurës disiplinore dhe mekanizmave të ankimit administrativ, këto komisione sigurojnë respektimin e etikës profesionale dhe funksionimin korrekt të sistemit të përgjegjësisë profesionale të parashikuar në ligj.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mbrojtjes së bimëve (AKVMB) ushtron funksione monitoruese në kuadër të zbatimit të këtij ligji, në bashkëpunim me Urdhrin e Agronomëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Monitorimi realizohet përmes veprimtarive inspektuese në terren, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve profesionale dhe teknike gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e agronomisë, si dhe ndihmon në identifikimin e rasteve të ushtrimit të profesionit në kundërshtim me kriteret ligjore të përcaktuara. Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve, struktura inspektuese shkëmben informacion me Urdhrin e Agronomëve për raste konkrete që lidhen me ushtrimin e profesionit dhe i referon ato, sipas rastit, për ndjekje disiplinore.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Profesioni i agronomit në Republikën e Shqipërisë është zhvilluar paralelisht me formimin akademik në fushën e shkencave bujqësore. Që nga viti 1951, agronomia është pjesë e ofertës së arsimit të lartë në vend, përmes strukturave universitare të dedikuara për bujqësinë, të cilat më pas janë konsoliduar në kuadër të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe, formimi i agronomëve është realizuar përmes programeve universitare dhe specializimeve të fokusuara në prodhimin bimor, menaxhimin e sistemeve bujqësore dhe aplikimin e njohurive shkencore në praktikë¹.

Aktualisht, agronomia ofrohet si specializim në kuadër të programit Bachelor “Shkenca Bujqësore dhe Siguri Ushqimi”, pjesë e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Programi përfshin përgatitje teorike dhe praktike në fusha që lidhen me kultivimin e bimëve, teknikat bujqësore dhe përdorimin e metodave bashkëkohore në sektorin bujqësor. Formimi profesional i agronomëve është zhvilluar në vazhdimësi në përputhje me evolucionin e kurrikulave universitare dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale në fushën e arsimit të lartë.

Në aspektin institucional, ushtrimi i profesionit të agronomit është realizuar historikisht në forma të ndryshme organizative, si në sektorin publik ashtu edhe në veprimtari private, pa një institucion të posaçëm përfaqësues profesional. Gjatë viteve, agronomët kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme të bujqësisë, mjedisit, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit rural, në funksion të kërkesave të tregut dhe strukturave ekzistuese institucionale. Zhvillimi historik i profesionit ka qenë i lidhur ngushtë me arsimin universitar dhe rolin e agronomit në sektorin bujqësor, duke reflektuar evolucionin e praktikave bujqësore dhe të politikave sektoriale ndër vite.

¹ Universiteti Bujqësor Tiranë <https://www.ubt.edu.al/>

Profesioni i agronomit, në vendin tonë, është përshkruar tradicionalisht si një profesion jetik, i lidhur drejtpërdrejt me funksionimin e prodhimit bujqësor dhe jetën rurale. Agronomi ka qenë figura profesionale e pranishme në terren, pranë fermerëve, me rol këshillues dhe teknik në organizimin e punimeve bujqësore, zgjedhjen e kulturave, përdorimin e inputeve, mbrojtjen e bimëve dhe orientimin e praktikave të kultivimit sipas kushteve të tokës dhe klimës. Në këtë kuptim, profesioni është ushtruar historikisht si një hallkë lidhëse mes dijes shkencore dhe prodhimit praktik bujqësor.

Siç pasqyrohet edhe në trajtimet mediatike² për këtë profesion, agronomi gjithmonë ka qenë pjesë përbërëse e ciklit të prodhimit bujqësor, duke ndjekur procesin nga planifikimi i mbjelljeve deri te korrja dhe menaxhimi i prodhimit. Roli i tij është shtrirë si në sektorin publik, përmes strukturave shtetërore dhe shërbimeve teknike bujqësore, ashtu edhe në sektorin privat, në formën e këshillimit profesional dhe veprimtarisë së pavarur. Në ndërgjegjen profesionale dhe publike, agronomi është konsideruar tradicionalisht si profesionist kyç për funksionimin e bujqësisë dhe mbështetjen teknike të fermerëve në vite.

Artikujt dhe debatet publike që trajtojnë profesionin e agronomit e vendosin këtë figurë profesionale në një vijimësi historike, duke e përshkruar si pjesë të pandashme të sistemit bujqësor shqiptar dhe të zhvillimit rural ndër dekada. Ky dimension historik e lidh profesionin ngushtë me evolucionin e praktikave bujqësore, organizimin e prodhimit dhe marrëdhëniet ndërmjet institucioneve, profesionistëve dhe fermerëve në Shqipëri.

Marrë shkas nga roli kyç që ka ky profesion në pjesën më të madhe të fushave që mbulon bujqësia Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Bujqësor ndërmerr masa për zhvillimin, mbrojtjen dhe kthimin e dinjitetit këtij profesioni duke mbrojtur atë ligjërisht.

Në nivel evropian, ushtrimi i profesioneve të lidhura me bujqësinë dhe organizimi i sistemeve bujqësore janë trajtuar historikisht në kuadër të politikave të zhvillimit rural dhe të Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB). Që prej dekadave të para të ndërtimit të saj, PPB ka përfshirë jo vetëm mekanizma mbështetës financiarë për fermat, por edhe dimensione që lidhen me organizimin teknik të prodhimit, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe profesionalizimin e sektorit bujqësor.

Në këtë kontekst, në vitet e fundit janë konsoliduar struktura dhe platforma analitike në nivel evropian që trajtojnë rolin e profesioneve bujqësore në funksionimin e sistemeve ushqimore dhe zhvillimit rural. Një ndër këto struktura është *Farm Europe* e themeluar në vitin 2015 me seli në Bruksel, e cila fokusohet në analizën e politikave bujqësore dhe rurale, veçanërisht në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore. *Farm Europe* ka kontribuar ndër vite në debatet evropiane mbi rolin e aktorëve profesionalë të bujqësisë, organizimin e zinxhirit ushqimor, sigurinë ushqimore dhe përshtatjen e bujqësisë ndaj sfidave mjedisore dhe klimatike, duke e vendosur profesionalizimin e sektorit si pjesë të diskutimit politik evropian.

Këto zhvillime reflektojnë një vijimësi historike të qasjes evropiane ndaj bujqësisë, ku organizimi i sektorit, roli i profesionistëve dhe lidhja mes dijes teknike dhe politikave

² <https://www.balkanweb.com/profisioni-jetik-per-bujqesine-drejt-zhdukjes-drejt-krijimit-urdhri-i-agronomit/#gsc.tab=0>

publike janë trajtuar si elementë të rëndësishëm të funksionimit të sistemeve bujqësore në BE³.

Zhvillimi i agronomisë si disiplinë shkencore dhe fushë profesionale ka qenë ndër vite i lidhur me organizimin e komuniteteve shkencore dhe profesionale që synojnë shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në prodhimin bujqësor. Në këtë kuadër, në vitin 1990 u krijua *European Society for Agronomy* (ESA)⁴, si një shoqatë shkencore që bashkon agronomë, studiues dhe ekspertë nga vende të ndryshme, me synimin për të promovuar shkencën e agronomisë dhe përdorimin e saj në bujqësi dhe zhvillim rural. ESA u konceptua si një forum i hapur, në të cilin trajtoheshin çështje që lidhen me marrëdhëniet bimë–tokë, sistemet e prodhimit bujqësor, mjedisin dhe qëndrueshmërinë e bujqësisë.

Për një periudhë disa dekadash, ESA funksionoi si shoqatë me strukturë formale, organe drejtuese dhe sekretariat administrativ, duke organizuar kongrese shkencore periodike dhe duke mbështetur shkëmbimin shkencor ndërmjet agronomëve dhe institucioneve kërkimore. Këto aktivitete kontribuan në konsolidimin e agronomisë si disiplinë ndërdisiplinore dhe në ndërtimin e një hapësire të përbashkët shkencore për trajtimin e sfidave të prodhimit bujqësor dhe menaxhimit të burimeve natyrore.

Me kalimin e kohës, modeli organizativ i ESA-s ka pësuar ndryshime. Pas diskutimeve të brendshme dhe vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme dhe anëtarët e saj në vitet 2017–2018, u vendos shpërbërja e ESA-s si shoqatë juridike dhe vazhdimi i veprimtarisë së saj në formën e një **rrjeti shkencor**. Që nga kjo periudhë, ESA funksionon si një rrjet i hapur bashkëpunimi, pa kuota anëtarësimi dhe pa struktura administrative të centralizuara, duke u fokusuar në ruajtjen e funksioneve shkencore dhe profesionale, veçanërisht organizimin e kongreseve çdo dy vjet dhe nxitjen e shkëmbimit të përvojës shkencore dhe praktike në agronomi.

Ky evolucion pasqyron mënyrën se si agronomia është organizuar tradicionalisht jo vetëm përmes strukturave formale, por edhe përmes rrjeteve fleksibël bashkëpunimi, duke reflektuar transformimet e vetë profesionit dhe të rolit të dijes shkencore në bujqësi. Organizimi i agronomëve dhe studiuesve në forma të ndryshme ndër vite tregon rëndësinë e vazhdueshme të këtij profesioni në funksionimin e sistemeve bujqësore dhe në zhvillimin e praktikave të qëndrueshme të prodhimit.

Krijimi dhe funksionimi i këtyre organizmave dhe rrjeteve profesionale evropiane pasqyrojnë në vijimësi rolin thelbësor që profesioni i agronomit ka luajtur dhe vijon të luajë në zhvillimin e bujqësisë. Këto struktura dëshmojnë rëndësinë e agronomisë si disiplinë shkencore dhe profesionale, si dhe kontributin e saj në përmirësimin e praktikave prodhuese, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe orientimin teknik të sektorit bujqësor. Në këtë kuptim, organizimi dhe bashkëpunimi profesional ndër vite reflektojnë vendin

³ “Farm Europe” është një organizatë e pavarur kërkimore dhe analitike, jo pjesë e administratës publike, e cila studion, analizon dhe prodhon argumente, analiza dhe rekomandime mbi politika publike në fusha të caktuara, për të informuar debatin politik dhe vendimmarrjen.

<https://www.farm-europe.eu/>

⁴ <https://european-agronomy.org/2021/01/18/dissolution-of-the-esa-association/>

qendror që ky profesion ka zënë në funksionimin e sistemeve bujqësore dhe në lidhjen ndërmjet dijes shkencore, praktikës prodhuese dhe politikave sektoriale.

Profesioni i agronomit në vendin tonë është zhvilluar historikisht në funksion të nevojave të bujqësisë për organizim teknik të prodhimit, menaxhim të tokës dhe aplikim të dijes shkencore në praktikë. Agronomia, si fushë e shkencave bujqësore, merret me prodhimin bimor, përdorimin racional të inputeve bujqësore, rritjen e rendimentit dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit, duke ndërthurur njohuri nga disiplinat bazë të shkencave natyrore dhe ekonomike që lidhen me bujqësinë.

Në rrjedhën historike, ushtrimi i profesionit të agronomit ka kaluar nga forma empirike e transmetimit të njohurive bujqësore drejt një modeli të mbështetur mbi arsimin universitar dhe kërkimin shkencor. Me zhvillimin e bujqësisë moderne, sidomos nga shekulli XIX e në vijim, roli i agronomit u konsolidua si profesion i specializuar, i lidhur ngushtë me eksperimentimin fushor, analizën e tokës, përzgjedhjen e varieteteve dhe përmirësimin e praktikave prodhuese.

Në nivel ndërkombëtar, ky zhvillim u shoqërua me krijimin e institucioneve akademike dhe kërkimore bujqësore, si dhe me organizimin e komuniteteve profesionale që synonin shkëmbimin e njohurive dhe standardizimin e praktikave bujqësore. Gjatë shekullit XX, në kushtet e rritjes së kërkesës për ushqim, mekanizimit të bujqësisë dhe përdorimit të teknologjive të reja, agronomi u shndërrua në një figurë kyçe për përkthimin e rezultateve shkencore në praktika konkrete prodhimi.

Në dekadat e fundit, profesioni i agronomit është përballur me sfida të reja që lidhen me ndryshimet klimatike, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë e produkteve dhe mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kontekst, roli i agronomit është zgjeruar përtej funksioneve tradicionale teknike, duke përfshirë këshillimin profesional, menaxhimin e integruar të fermës dhe zbatimin e praktikave të mira bujqësore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në Shqipëri, profesioni i agronomit lidhet ngushtë me zhvillimin e bujqësisë dhe jetën rurale. Agronomi ka ushtruar një rol aktiv në terren, pranë fermerëve, si profesionist këshillues dhe teknik në organizimin e punimeve bujqësore, përzgjedhjen e kulturave, përdorimin e inputeve dhe mbrojtjen e bimëve. Ky rol është ushtruar si në sektorin publik, përmes strukturave shtetërore dhe shërbimeve teknike bujqësore, ashtu edhe në sektorin privat, në formën e këshillimit profesional dhe veprimtarisë së pavarur.

Megjithatë, ushtrimi i profesionit është realizuar për një periudhë të gjatë pa një kuadër të posaçëm ligjor dhe institucional që të garantojë standarde të unifikuara profesionale, përgjegjësi etike dhe mbikëqyrje të veprimtarisë. Transformimet ekonomike dhe institucionale pas viteve 1990, fragmentimi i strukturës së fermave, zhvillimi i tregut të inputeve bujqësore dhe rritja e kërkesave për cilësi dhe siguri ushqimore kanë nxjerrë në pah nevojën për një organizim më të qartë dhe më të konsoliduar të profesionit të agronomit.

Në këtë kuadër, ndërhyrja për rregullimin dhe organizimin e profesionit përfaqëson një vijimësi logjike të zhvillimit historik të tij, duke synuar forcimin e rolit profesional të

agronomit në sektorin bujqësor, rritjen e përgjegjësisë profesionale dhe garantimin e interesit publik në funksionimin e sistemit bujqësor.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Përcaktimi i problemit

Problemi që trajtohet lidhet me mungesën e një kuadri ligjor dhe institucional të konsoliduar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të agronomit në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, ky profesion ushtrohet pa u mbështetur në një strukturë të posaçme publike ose profesionale që të sigurojë rregulla të detyrueshme për aksesin në profesion, standarde të qarta për ushtrimin e tij, si dhe mekanizma përgjegjësie dhe disipline profesionale. Kjo mospërputhje midis rëndësisë publike të profesionit dhe mungesës së rregullimit përkatës përbën thelbin e problemit në shqyrtim.

Si pasojë e kësaj mungese rregullimi, ushtrimi i profesionit të agronomit zhvillohet në mënyrë të pakoordinuar me institucionet publike përgjegjëse për politikën bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore, si dhe me strukturat këshilluese dhe kontrolluese të sektorit. Në praktikë, kjo ka sjellë ofrimin e shërbimeve teknike agronomike pa rregulla të unifikuara cilësie, pa kritere të detyrueshme profesionale dhe pa mekanizma efektivë kontrolli dhe përgjegjshmërie, duke ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimeve që u ofrohen fermerëve dhe operatorëve ekonomikë, në zbatimin e qëndrueshëm të politikave publike dhe në besimin e publikut ndaj këtij profesioni.

Shkaqet kryesore të identifikuara të kësaj situatë lidhen, së pari, me mungesën e një kuadri ligjor që e njeh dhe e rregullon profesionin e agronomit si profesion me funksion publik dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore, mjedisin dhe zhvillimin territorial. Së dyti, mungon një ent publik profesional që të ushtrojë vetërregullim, mbikëqyrje dhe kontroll disiplinor mbi ushtrimin e profesionit, si dhe të promovojë formimin profesional të vazhdueshëm. Së treti, mungesa e mbrojtjes ligjore të titullit profesional “Agronom” krijon konfuzion në tregun e shërbimeve profesionale dhe cenon standardet e ushtrimit të profesionit.

Problemi ka shtrirje kombëtare dhe prek një gamë të gjerë aktorësh. Ai ndikon drejtpërdrejt te agronomët, të cilët ushtrojnë profesionin në mungesë sigurie ligjore dhe mekanizmash të qartë përgjegjësie, si dhe te Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore, të cilat nuk disponojnë një instrument institucional për garantimin e cilësisë së shërbimeve profesionale. Po ashtu, preken fermerët dhe operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor, të cilët përfitojnë shërbime

këshilluese pa standarde të unifikuara, si dhe konsumatorët, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të këtij profesioni me sigurinë dhe cilësinë e prodhimit ushqimor.

Problemi nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes mekanizmave aktualë dhe as të vetërregullohet nga tregu i shërbimeve profesionale. Për shkak se profesioni i agronomit ushtron funksion publik dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në interesa themelore publike, si siguria ushqimore, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe zbatimi i politikave kombëtare dhe angazhimeve ndaj Bashkimit Evropian, ndërhyrja përmes ndryshimit të politikave është e domosdoshme.

Në thelb, problemi është i natyrës institucionale dhe rregullatore dhe konsiston në mungesën e një sistemi ligjor dhe organizativ që të sigurojë ushtrimin e përgjegjshëm, të kontrolluar dhe të integruar të profesionit të agronomit në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe adresohet përmes miratimit të politikës së duhur e cila do vendosë kornizën rregullatore për këtë çështje.

Shkaqet e problemit

1. Mungesa e kuadrit ligjor rregullator

Profesioni i agronomit nuk është i rregulluar me ligj të posaçëm si profesion i rregulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, çka ka bërë që ushtrimi i tij të mos mbështetet në rregulla të detyrueshme për aksesin, standardet profesionale dhe përgjegjësinë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

2. Mungesa e një enti publik profesional për mbikëqyrje dhe vetërregullim

Aktualisht nuk ekziston një strukturë institucionale që të ushtrojë kontroll profesional, disiplinor dhe etik mbi ushtrimin e profesionit të agronomit, si dhe të garantojë formimin profesional të vazhdueshëm. Kjo ka ndikim të shumëfishtë duke prekur në të njëjtën kohë disa fusha sic janë: siguria ushqimore, investimi i fermerëve në veprimtarinë e tyre duke qënë se ushtrimi i profesionit të agronomit ka ndikim direkt në mbrojtjen e bimëve etj.

3. Mungesa e mbrojtjes ligjore të titullit profesional “Agronom”

Titulli profesional nuk është i mbrojtur ligjërisht, duke lejuar ushtrimin e veprimtarive agronomike pa kualifikim të verifikuar dhe duke krijuar konfuzion në tregun e shërbimeve profesionale.

4. Mungesa e koordinimit institucional

Ushtrimi i profesionit zhvillohet pa mekanizma të qartë bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet publike përgjegjëse për politikën bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore.

5. Shtrirja e problemit

1. Shtrirje kombëtare në sektorin bujqësor

Problemi prek të gjithë territorin e vendit, pasi shërbimet profesionale agronomike ofrohen në mënyrë të paunifikuar dhe pa standarde të detyrueshme cilësie dhe kontrolli.

2. Ndikim te zbatimi i politikave bujqësore, mjedisore

Mungesa e rregullimit ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm të politikave bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore.

3. Ndikim te shërbimet ndaj fermerëve dhe konsumatorëve

Cilësia dhe besueshmëria e shërbimeve këshilluese teknike ndaj fermerëve dhe operatorëve ekonomikë ndikohet negativisht, me pasoja të drejtpërdrejta për produktivitetin bujqësor dhe sigurinë ushqimore.

4. Ndikim te besimi publik

Mungesa e standardeve dhe mekanizmave të përgjegjësisë ul besimin e publikut dhe institucioneve ndaj profesionit të agronomit.

Grupet e prekura nga ky problem:

Grupet e prekura të identifikuara janë:

- Agronomët
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Fermerët
- Operatorët ekonomike në sektorin bujqësor
- Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore
- Konsumatorët

Grupet e sipërcituara preken nga problematikat në mënyra të ndryshme.

Agronomët

Preken drejtpërdrejt nga mungesa e kuadrit ligjor, e cila krijon pasiguri në ushtrimin e profesionit dhe mungesë mbrojtjeje për titullin “agronom”. Mungesa e një enti vetërregullues dhe e standardeve profesionale çon në diferenca në praktikë, mungesë përgjegjshmërie disiplinore dhe ulje të besueshmërisë së profesionit në treg.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rura

Preket nga mungesa e një instrumenti institucional për mbikëqyrjen e profesionit, çka kufizon aftësinë për të garantuar cilësinë e shërbimeve agronomike. Kjo sjell vështirësi në koordinimin e politikave bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore dhe rrit barrën administrative për kontrollin e sektorit.

Fermerët

Preken për shkak se përfitojnë shërbime këshilluese pa standarde të unifikuara dhe pa garanci për cilësinë profesionale. Kjo rrit rrezikun për vendimmarrje të pasakta në menaxhimin e fermës, ndikon negativisht në produktivitet, kosto dhe në zbatimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore.

Operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor

Ndikohen nga pasiguria në cilësinë e shërbimeve profesionale që përdorin në proceset e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit. Mungesa e standardeve dhe kontrollit profesional rrit rrezikun për mosrespektim të kërkesave ligjore dhe teknike, sidomos në lidhje me sigurinë ushqimore dhe tregjet.

Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore

Preken nga mungesa e koordinimit institucional me profesionin e agronomit, duke vështirësuar zbatimin efektiv të politikave dhe kontrolleve sektoriale. Mungesa e një strukture profesionale të organizuar ul efikencën e ndërhyrjeve publike dhe konsolidimin e standardeve.

Konsumatorët

Preken në mënyrë indirekte përmes ndikimit që mungesa e standardeve profesionale ka mbi cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore. Kjo situatë rrit rrezikun për produkte jo të sigurta dhe ul besimin e publikut në zinxhirin ushqimor

Problemi i identifikuar nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes ndërhyrjeve fragmentare ose mekanizmave ekzistues rregullatorë, por kërkon domosdoshmërisht një ndryshim të qëndrueshëm të politikave. Për këtë arsye, zgjidhja konsiston në hartimin e një kornize të vetme, të qartë dhe solide ligjore, e cila ka për qëllim të rregullojë ushtrimin e profesionit të agronomit si profesion me funksion publik, të vendosë mekanizma detyrues për mbikëqyrje dhe përgjegjësi profesionale, si dhe të sigurojë integritetin e këtij profesioni në zbatimin e politikave publike bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë, pasi situata aktuale tregon se ushtrimi i profesionit të agronomit nuk mbështetet në një kuadër ligjor dhe institucional të përshtatshëm me rëndësinë dhe funksionin publik që ky profesion ka. Mungesa e rregullimit sjell ofrim shërbimesh profesionale pa standarde të detyrueshme cilësie, pa mekanizma të qartë përgjegjësie dhe pa koordinim efektiv me politikat publike bujqësore, mjedisore dhe të sigurisë ushqimore. Për këtë arsye, ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të vendosur rregulla të qarta dhe të detyrueshme, për të mbrojtur interesin publik dhe për të garantuar një ushtrim të përgjegjshëm dhe të kontrolluar të profesionit të agronomit.

Kjo nismë është në përputhje me objektivat e nivelit të lartë të Qeverisë, të pasqyruara në dokumentat e mëposhtëm strategjikë:

1. Strategjia së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027;
2. Programi Qeverisës 2021-2025.
3. Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023–2027.

Në kuadër të politikave të përgjithshme të bujqësisë, pas 2020-ës, të BE-së, ngritja, buxhetimi dhe funksionimi i Sistemin e Njohurive dhe të Inovacionit Bujqësor (SNJIB) është një objektiv kriteri i detyrueshëm për vendet anëtare për të marrë miratimin për financimin e planeve strategjike përkatëse, që i paraqiten Komisionit Evropian për miratim të buxheteve.

Transferimi i njohurive dhe i inovacionit sjell kërkimin bujqësor, inovacionin dhe shërbimet e ekstensionit më afër nevojave të fermerit, duke pasur një këndvështrim afatgjatë për një qasje të re institucionale në dhënien e informacionit dhe njohurive, duke ngritur Sistemin e Njohurive dhe të Inovacionit Bujqësor, domethënë duke zbatuar praktikatat më të mira të BE-së.

Struktura e reformuar e ekstensionit këshillimor të MBZHR-së (SHKKB) përfshin në total 261 punonjës në mbarë vendin, nga të cilët 189 janë ekstensionistë (kryejnë detyra këshillimi), shumica e të cilëve janë të trajnuar në agronomi, blegtori ose ekonomi dhe ka një pjesë e madhe e tyre janë me moshë të madhe. Strategjia në vendosjen e objektivave në bujqësi ka qartësuar ndërmarren e disa hapave si transferimi i njohurive dhe i inovacionit.

Meqenëse inovacioni dhe transferimi i njohurive kanë kapacitetin për të nxitur zhvillimin dhe konkurrencën, boshllëqet në ndërtimin e një SNJIB-je dhe përshpejtimin e transferimit të teknologjisë të fermerët duhet të vlerësohen dhe adresohen në vijimësi.

SHKKB-ja duhet të organizohet në atë mënyrë, që masat e SNJIB-së të integrohen në të gjitha aktivitetet e tij, si trajnimi i këshilltarëve, shkëmbimi i njohurive me studiuesit-kërkuesit shkencorë, organizimi ose pjesëmarrja në demonstrimet në fermë, planifikimi dhe përdorimi i buxhetit për mobilitetin e këshilltarëve, për të mësuar nga praktikatat dhe eksperiencat jashtë vendit dhe për të shpërndarë njohuri të reja në vend/rajon. Është thelbësore që njohuritë të zbatohen në praktikë në mënyrë koncize dhe të kuptueshme. Ngritja e një SNJIB-je do të thotë të hapësh SHKF-në, duke përfshirë të gjithë këshilltarët publikë dhe privatë, për të forcuar dhënien e këshillave dhe rritjen e kompetencave këshilluese. Për shkak të financimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së kapaciteteve, progresi i arritur deri më tani ka qenë i kufizuar⁵.

Ndërkaq objektivat e qeverisë për zhvillimin e bujqësisë, forcimin e ekonomisë rurale dhe integrimin evropian kërkojnë një sektor bujqësor modern, konkurrues dhe të qëndrueshëm, të mbështetur në njohuri profesionale të certifikuara dhe standarde të larta teknike. Në këtë kuadër, profesioni i agronomit përbën një hallkë kyçe në zbatimin e politikave bujqësore, zhvillimin e zinxhirëve të integruar të prodhimit, përdorimin e teknologjive moderne dhe garantimin e sigurisë ushqimore.

Nisma synon të krijojë bazën ligjore dhe institucionale që i mungon aktualisht sektorit, duke garantuar ushtrim të përgjegjshëm dhe të kontrolluar të profesionit dhe duke e vendosur agronomin në funksion të drejtpërdrejtë të objektivave të qeverisë për zhvillim rural të qëndrueshëm, ekonomi të gjelbër dhe integrim të plotë në Bashkimin Evropian.

Fusha e agronomisë ka lidhje thelbësore me Strategjinë Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023–2027, pasi ajo e trajton sigurinë ushqimore si rezultat të drejtpërdrejtë të mënyrës se si planifikohet, menaxhohet dhe zbatohet prodhimi bujqësor që në fazën fillestare të zinxhirit ushqimor. Strategjia thekson nevojën për kontrollë parandaluese, qasje të bazuar në risk, mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe përdorimin e qëndrueshëm të inputeve

⁵ Strategjia së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027, fq. 64.

bujqësore, elemente që varen drejtpërdrejt nga ekspertiza teknike agronomike në nivel ferme dhe territori. Në këtë kontekst, agronomia nuk shihet thjesht si profesion mbështetës, por si instrument politikash publike për realizimin e objektivave të sigurisë ushqimore, mbrojtjes së konsumatorit dhe përafrimit me *acquis* të BE-së.

Pa një trupë agronomësh të rregulluar, të certifikuar dhe të mbikëqyrur institucionalisht, objektivat e Strategjisë për një sistem agroushqimor të bazuar në evidencë shkencore, koordinim ndërinstitutional dhe qasjen “One Health” nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive, veçanërisht në hallkat kyçe të prodhimit primar ku rreziku lind dhe ku ndërhyrja profesionale është vendimtare.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të ngrihen dhe të bëhen funksionale 100% e organeve drejtuese dhe disiplinore të Urdhrit të Agronomëve, sipas përcaktimeve të ligjit.
6. Brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, të regjistrohen në regjistrin profesional të Urdhrit të Agronomëve të paktën 90% e agronomëve që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.
7. Brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, të reduktohet me të paktën 80% numri i rasteve të identikuara të ushtrimit të profesionit nga persona të paregjistruar në Urdhrin e Agronomëve.
8. Të zhvillohen jo më pak se 4 aktivitete formimi profesional në vit dhe të përfshihen në to të paktën 50% e agronomëve të regjistruar, me qëllim përmirësimin e standardeve profesionale dhe etike të ushtrimit të profesionit.

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

1. Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së (mosndërhyrja)

Avantazhe:

- Nuk kërkon ndërhyrje ligjore apo kosto shtesë buxhetore.
- Ruhët situata institucionale ekzistuese.

Disavantazhe:

- Nuk adreson problematikat ekzistuese të ushtrimit të profesionit.
- Mungojnë mekanizmat e mbikëqyrjes, etikës dhe përgjegjësisë profesionale.
- Roli i agronomit mbetet i paformalizuar dhe i pakoordinuar.

Ky opsion ruan gjendjen aktuale pa sjellë përmirësime në organizimin dhe ushtrimin e profesionit.

2. Opsioni 1 – (Rregullator) Miratimi i ligjit për krijimin e Urdhrit të Agronomit (opsioni i preferuar)

Avantazhe:

- Vendos për herë të parë një kuadër të plotë ligjor për profesionin.
- Krijon mekanizma të qartë mbikëqyrjeje, etike dhe disiplinore.
- Rrit përgjegjshmërinë profesionale dhe mbrojtjen e interesit publik.
- Përputhet me praktikën evropiane për profesionet me funksion publik.

Disavantazhe:

- Kërkon ndërtim institucional të ri dhe masa tranzitore.
- Impikon kosto fillestare administrative.

Ky opsion ofron zgjidhje të plotë dhe të strukturuar për rregullimin e profesionit të agronomit.

3. Opsioni 2 – (Rregullator) Rregullimi i pjesshëm përmes legjislacionit sektorial

Avantazhe:

- Mund të zbatohet pa krijuar një institucion të ri.
- Integron agronomin në kuadro ligjore ekzistuese.

Disavantazhe:

- Fragmenton rregullimin ligjor të profesionit.
- Nuk krijon mekanizëm vetërregullues profesional.
- Nuk garanton mbikëqyrje etike dhe disiplinore të vazhdueshme.

Ky opsion sjell rregullim të kufizuar dhe jo koherent të profesionit.

4. Opsioni 3 – (Jorregullator) Përmirësimi i praktikave administrative

Avantazhe:

- Mund të japë përmirësime të shpejta në afat të shkurtër.
- Nuk kërkon ndërhyrje ligjore.

Disavantazhe:

- Nuk zgjidh mungesën e rregullimit ligjor të profesionit.
- Nuk krijon detyrime të qarta dhe kontroll profesional të qëndrueshëm.
- Efektet janë të kufizuara dhe jo afatgjata.

Ky opsion ka efekt të kufizuar dhe nuk adreson thelbin e problematikës.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.\
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni)*

Grupet e prekura nga projektligji janë:

- Agronomët
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Fermerët
- Operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor
- Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore
- Konsumatorët

Ndikimet sipas grupeve të prekura

1) Agronomët (ndikim kryesisht i drejtpërdrejtë)

Ndikime të drejtpërdrejta:

- Formalizimi i ushtrimit të profesionit përmes regjistrimit dhe anëtarësimit në Urdhrin e Agronomit
- Rritja e përgjegjshmërisë dhe etikës profesionale
- Qartësimi i të drejtave dhe detyrimeve profesionale

Ndikime sasiore:

- Numri i agronomëve të regjistruar dhe të pajisur me leje profesionale;
- Numri i lejeve të lëshuara dhe të rinovuara;
- Numri i krediteve profesionale dhe i pjesëmarrjeve në trajnime;
- Numri i ricertifikimeve periodike

Vlerësim monetar:

- Agronomët do të përballojnë kosto të drejtpërdrejta për kuotën e anëtarësimit, lejen profesionale, kreditë, trajnimet dhe shërbimet e tjera të Urdhrit. Për qëllime të kësaj analize, këto kosto janë përlogaritur në mënyrë hipotetike, duke marrë si referencë tarifat e aplikuar nga Këshilli Veterinar Shqiptar. Përfitimet ekonomike që lidhen me rritjen e besueshmërisë profesionale, mbrojtjen e titullit dhe mundësitë e punësimit nuk mund të monetarizohen saktësisht në këtë fazë.

2) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (ndikim i drejtpërdrejtë)

Ndikime të drejtpërdrejta:

- Qartësim i roleve institucionale
- Ulje e barrës administrative përmes transferimit të proceseve të regjistrimit dhe kontrollit të Urdhrit
- Kalim nga rol operacional në rol strategjik dhe mbikëqyrës

Ndikime sasiore:

- Reduktim i përfshirjes direkte administrative në proceset operationale

Vlerësim monetar:

- Kosto fillestare për koordinim dhe mbështetje institucionale

- Pa kosto shtesë afatgjata të konsiderueshme

3) Fermerët (ndikim kryesisht jo i drejtpërdrejtë)

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- Përmirësim i cilësisë së këshillimit teknik
- Rritje e besueshmërisë në shërbimet profesionale
- Përmirësim i vendimmarrjes në proceset prodhuese

Ndikime sasiore:

- Vlerësimi sasior nuk është i mundur në këtë fazë për shkak të mungesës së të dhënave të drejtpërdrejta

Vlerësim monetar:

- Efekte indirekte pozitive në eficiencën e prodhimit dhe të ardhurat

4) Operatorët ekonomikë në sektorin bujqësor (ndikim kryesisht jo i drejtpërdrejtë)

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- Rritje e standardeve profesionale në shërbimet teknike
- Përmirësim i bashkëpunimit me ekspertë të licencuar

Ndikime sasiore:

- Vlerësimi sasior nuk është i disponueshëm në këtë fazë

Vlerësim monetar:

- Nuk parashikohen kosto direkte të detyrueshme; kostot lidhen vetëm me kontraktimin e shërbimeve profesionale kur kërkohet

5) Institucionet publike të lidhura me sektorin (ndikim jo i drejtpërdrejtë)

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- Standardizim i ekspertizës profesionale të përdorur
- Lehtësim i bashkëpunimit ndërinstitutional

Ndikime sasiore dhe monetare:

- Për institucionet publike të lidhura me sektorin nuk identifikohet një efekt financiar i veçantë, pasi bashkëpunimi, verifikimi i statusit profesional dhe shkëmbimi i informacionit parashikohet të realizohen nga strukturat ekzistuese dhe brenda fondeve të miratuara. Efekti financiar publik lidhet me ngritjen dhe funksionimin fillestar të Urdhrit dhe është përlogaritur në mënyrë hipotetike në seksionin përkatës të analizës financiare.

6) Konsumatorët (ndikim jo i drejtpërdrejtë)

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- Përmirësim i sigurisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore

Ndikime sasiore dhe monetare:

- Vlerësimi sasior dhe monetar nuk është i mundur në këtë fazë, pasi ndikimet janë indirekte dhe afatmesme

Përmbledhje e kostove dhe përfitimeve:

- Kosto direkte publike: të kufizuara dhe të natyrës fillestare për koordinim institucional

- Kosto direkte private: kryesisht për agronomët (anëtarësim, ricertifikim) dhe në raste të caktuara për operatorët ekonomikë
- Përfitime direkte: për agronomët dhe institucionet (formalizim, rritje e cilësisë dhe qeverisjes)
- Përfitime indirekte: për fermerët, operatorët, institucionet dhe konsumatorët (rritje e cilësisë, besueshmërisë dhe eficiencës në sektor)

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimintuaj.*

Opsioni 0 - Ruajtja e status quo së (mosndërhyrja)

Ruajtja e gjendjes aktuale, pa ndërmarrë nisma ligjore për rregullimin e ushtrimit të profesionit të agronomit, nënkupton mosadresimin e problematikave të evidentuara në lidhje me ushtrimin e pakontrolluar të profesionit, mungesën e mekanizmave të mbikëqyrjes, përgjegjësisë dhe etikës profesionale. Ky opsion nuk krijon asnjë përmirësim në mënyrën e ushtrimit të profesionit dhe nuk mundëson shfrytëzimin e plotë të rolit të agronomit në mbështetje të politikave bujqësore, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit rural, duke ruajtur të pandryshuar situatën ekzistuese.

Opsioni 1 - (rregullator) Miratimi i një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit (opsioni i preferuar)

Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri të posaçëm, që rregullon ushtrimin e profesionit të agronomit përmes krijimit të Urdhrit të Agronomëve, si ent publik profesional. Duke qenë se nuk ekziston një ligj i mëparshëm që rregullon këtë profesion, ky opsion ofron një zgjidhje të plotë dhe të drejtpërdrejtë të problematikave të konstatuara, duke vendosur për herë të parë:

- rregulla të qarta për aksesin dhe ushtrimin e profesionit;
- mekanizma mbikëqyrjeje, etike dhe disiplinore;
- përgjegjësi profesionale dhe ricertifikim periodik;
- rol të strukturuar të agronomit në shërbim të interesit publik.

Ky opsion është në përputhje me praktikatat evropiane për profesionet me funksion publik dhe krijon bazën ligjore të nevojshme për forcimin institucional të profesionit të agronomit.

Opsioni 2 - (rregullator) Rregullimi i pjesshëm përmes legjislacionit ekzistues sektorial

Ky opsion do të konsistonte në përfshirjen e dispozitave për agronomin në ligje të tjera sektoriale ekzistuese (p.sh. ligje për bujqësinë dhe zhvillimin rural). Megjithatë, ky opsion nuk ofron një rregullim të plotë dhe koherent të profesionit, pasi fragmenton rregullimin ligjor, nuk krijon një mekanizëm vetërregullues profesional dhe nuk garanton mbikëqyrje të vazhdueshme etike dhe disiplinore si dhe kërkon shumë angazhim administrativ dhe ka kosto të lartë. Si i tillë, ky opsion nuk përzgjidhet nga ana jonë si opsioni i preferuar.

Opsioni 3 - (jorregullator) Përmirësimi i praktikave administrative dhe zbatimit në terren

Ky opsion parashikon forcimin e praktikave administrative ekzistuese, përmes trajnimeve, orientimeve teknike dhe rritjes së monitorimit nga institucionet publike përgjegjëse.

Megjithëse mund të sjellë përmirësime të kufizuara në afat të shkurtër, ky opsion nuk zgjidh problemin themelor të mungesës së rregullimit ligjor të profesionit, nuk krijon detyrime të qarta për ushtrimin e profesionit dhe nuk garanton kontroll profesional të qëndrueshëm. Për rrjedhojë, ky opsion mbetet joefektiv për adresimin e plotë të problematikës.

Përfundimisht, Opsioni 1 është zgjedhur duke analizuar opsionet e mësipërme, opsioni i miratimit të një ligji të ri për krijimin e Urdhrit të Agronomit përbën opsionin më të përshtatshëm dhe efektiv, pasi adreson në mënyrë të plotë dhe të strukturuar problematikat ekzistuese, krijon një kuadër të qartë ligjor dhe institucional dhe siguron ushtrimin e profesionit të agronomit në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative.

1. Efektiviteti në ngritjen dhe funksionimin institucional brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, përmes ngritjes së strukturave administrative funksionale të Urdhrit të Agronomit, sigurimit të burimeve njerëzore dhe financiare-5
2. Efektiviteti në garantimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes profesionale brenda 2 viteve nga miratimi i projektligjit, përmes funksionimit të regjistrimit profesional, inspektimeve periodike dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore përkatëse-5
3. Efektiviteti në nxitjen e angazhimit të profesionistëve në Urdhrin e Agronomit brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e projektligjit përmes anëtarësimit në organet drejtuese dhe përmbushjes së detyrimeve profesionale-4
4. Koherenca me kuadrin ligjor në fuqi përmes përqendrimit të kompetencave profesionale në Urdhrin e Agronomit, duke shmangur mbivendosjet institucionale- 4
5. Kosto efektiviteti-5

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në zbatueshmërinë institucionale brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, përmes ngritjes së	5	0	0	5	25	1	5	0	0

strukturave administrative funksionale të Urdhrit të Agronomit, sigurimit të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe miratimit të akteve nënligjore të nevojshme për funksionimin e tij-									
Efektiviteti në garantimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes profesionale brenda 2 viteve nga miratimi i projektligjit, përmes funksionimit të regjistrit profesional, inspektimeve periodike dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore përkatëse-	5	0	0	4	20	1	5	0	0
Efektiviteti në nxitjen e angazhimit të profesionistëve në Urdhrin e Agronomit brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e projektligjit përmes anëtarësimit në organet drejtuese dhe përmbushjes së detyrimeve profesionale	4	0	0	3	12	1	4	0	0
Koherenca me kuadrin ligjor në fuqi përmes përqendrimit të kompetencave profesionale në Urdhrin e Agronomit, duke shmangur mbivendosjet institucionale	4	0	0	4	16	1	4	0	0
Kosto-efektiviteti	5	0	0	5	25	2	10	0	0
Pikët totale për secilin opsion			0		98		28		0

Analiza me shumë kriterë tregon se opsioni 1 miratimi i projektligjit “Për urdhërin e Agronomit” është vlerësuar me më shumë pikë dhe është zgjedhur si opsionin i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Në nivel kombëtar, njësia përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me institucionet e saj të varësisë, në përputhje me kompetencat që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji nga MBZHR dhe organet e vet Urdhërit të Agronomit, si vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Komisioni i Përkohshëm për organizimin e Urdhrit të Agronomëve;
- c) Urdhri i Agronomëve;
- ç) Organet drejtuese qendrore dhe rajonale të Urdhrit të Agronomëve;
- d) Komisionet Disiplinore.-

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron monitorimin e zbatimit të ligjit në kuadër të rolit të saj si autoritet politikëbërës në fushën e bujqësisë dhe si institucion përgjegjës për bashkëpunimin institucional me Urdhrin e Agronomëve. Ministria monitoron funksionimin e përgjithshëm të kuadrit rregullator përmes informimit periodik nga Urdhri mbi anëtarësimet dhe masat disiplinore, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e projekteve dhe dokumenteve politike në fushën e agronomisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Komisioni i Përkohshëm për organizimin e Urdhrit të Agronomëve i nënshtrohet monitorimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë fazës tranzitore të zbatimit të ligjit. Monitorimi konsiston në verifikimin e përmbushjes së detyrës së tij kryesore, që lidhet me organizimin e zgjedhjeve të para për këshillat rajonale dhe Këshillin Kombëtar të Urdhrit, brenda afatit të përcaktuar në ligj, deri në shpërbërjen e tij me konstituimin e organeve drejtuese.

Urdhri i Agronomëve, si ent publik profesional, është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin e ushtrimit të profesionit të agronomit. Monitorimi realizohet përmes mbajtjes dhe administrimit të regjistrit profesional, mbikëqyrjes së ushtrimit të profesionit, zbatimit të rregullave të etikës dhe disiplinës profesionale, si dhe përmes zbatimit të procedurave për dhënien, pezullimin ose heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e miratuara nga organet e tij.

Komisionet Disiplinore monitorojnë zbatimin e ligjit nëpërmjet shqyrtimit të ankesave dhe trajtimit të shkeljeve profesionale që lidhen me ushtrimin e profesionit të agronomit. Nëpërmjet procedurës disiplinore dhe mekanizmave të ankimit administrativ, këto komisione sigurojnë respektimin e etikës profesionale dhe funksionimin korrekt të sistemit të përgjegjësisë profesionale të parashikuar në ligj.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mbrojtjes së bimëve (AKVMB) ushtron funksione monitoruese në kuadër të zbatimit të këtij ligji, në bashkëpunim me Urdhrin e Agronomëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Monitorimi realizohet përmes veprimtarive inspektuese në terren, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve profesionale dhe teknike gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e agronomisë, si dhe ndihmon në identifikimin e rasteve të ushtrimit të profesionit në kundërshtim me kriteret ligjore të përcaktuara. Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve, struktura inspektuese shkëmben informacion me Urdhrin e Agronomëve për raste konkrete që lidhen me ushtrimin e profesionit dhe i referon ato, sipas rastit, për ndjekje disiplinore. Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Zbatimi i këtij projektligji mund të përballët me disa pengesa, kryesisht të natyrës administrative dhe institucionale, si më poshtë:

Mungesa e përvojës institucionale në vetërregullimin profesional: ngritja për herë të parë e një strukture vetërregulluese për profesionin e agronomit mund të shoqërohet me vështirësi fillestare në funksionimin efektiv të organeve të Urdhrit, në miratimin e akteve nënligjore dhe në zbatimin e mekanizmave disiplinorë dhe etikë.

Përshtatja graduale e profesionistëve dhe punëdhënësve me kërkesat e reja ligjore: Vendosja e detyrimit për anëtarësim, regjistrim dhe certifikim mund të kërkojë kohë për t'u zbatuar nga agronomët dhe subjektet punëdhënëse, duke krijuar vonesa fillestare në zbatimin e plotë të ligjit.

Rreziku i ushtrimit të profesionit në mënyrë joformale: Ekziston rreziku që një pjesë e profesionistëve të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin pa u regjistruar në Urdhrin e Agronomit, duke kufizuar efektivitetin e ligjit dhe duke krijuar konkurrencë të padrejtë në tregun e shërbimeve profesionale.

Përdorimi i shërbimeve nga profesionistë jo të licencuar: Fermerët dhe operatorët e sektorit bujqësor mund të vijnë në përdorin shërbime këshillimore nga persona të paregjistruar ose pa përmbushur kriteret ligjore, duke cenuar cilësinë e shërbimeve dhe qëllimin e ligjit për garantimin e standardeve profesionale.

Sigurimi dhe qëndrueshmëria e financimit gjatë periudhës tranzitore: Zbatimi i ligjit kërkon garantimin efektiv të financimit publik në fazën fillestare, si dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm financiarë për funksionimin e Urdhrit pas përfundimit të mbështetjes buxhetore.

Këto pengesa konsiderohen të kapërcyeshme dhe të natyrshme për fazën fillestare të zbatimit të një kuadri të ri rregullator.

Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për arritjen e qëllimeve të politikës

Për të garantuar zbatimin efektiv të ligjit dhe arritjen e qëllimeve të politikës, parashikohen këto masa:

1. **Për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe funksionimit të Urdhrit:** Do të miratohen aktet nënligjore brenda afateve të përcaktuara, si dhe do të sigurohet

asistencë teknike dhe institucionale për ngritjen dhe funksionimin efektiv të organeve të Urdhrit të Agronomit, përfshirë zhvillimin e procedurave administrative, disiplinore dhe të regjistrimit profesional.

2. Të organizohen jo më pak se 4 aktivitete informuese/trajnuese në vit për agronomët, punëdhënësit dhe operatorët e sektorit bujqësor mbi kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji.
3. Për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e ligjit, Urdhri i Agronomëve, MBZHR-ja dhe strukturat përgjegjëse inspektuese do të bashkëpunojnë për regjistrimin e të paktën 95% të agronomëve që ushtrojnë profesionin brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, përmes shkëmbimit të informacionit, aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe monitorimit të respektimit të detyrimeve ligjore për ushtrimin e profesionit.
4. Urdhri i Agronomëve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrotjtjes së Bimëve (AKVMB), do të sigurojë që 100% e rasteve të ushtrimit të profesionit nga persona të paregjistruar, të identifikuar gjatë veprimtarive monitoruese dhe inspektuese ose të referuara pranë Urdhrit, të trajtohen në përputhje me procedurat dhe masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi.
5. **Për kufizimin e përdorimit të shërbimeve nga profesionistë jo të licencuar:** Do të promovohen standardet profesionale dhe rëndësia e përdorimit të shërbimeve të licencuara, si dhe do të forcohet kërkesa për angazhimin e agronomëve të regjistruar.

Kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit. Zbatimi i këtij projektligji kërkon përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”;
- legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe njohjen e kualifikimeve profesionale në fushën e agronomisë;
- legjislacionin për inspektimin, disiplinën administrative dhe transparencën institucionale;
- standardet evropiane për rregullimin e profesioneve me funksion publik.

Të gjitha këto mund t’i vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projektligjit “Për Urdhrin e Agronomit” do të realizohet përmes një sistemi të kombinuar institucional, nën koordinimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Urdhrin e Agronomëve dhe strukturat e tjera të parashikuara nga ligji. Monitorimi synon të vlerësojë shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore, funksionimin e mekanizmave të vetërregullimit profesional, si dhe efektivitetin e strukturave organizative të Urdhrit në nivel qendror dhe rajonal.

Ky proces do të realizohet përmes:

- raportimeve periodike 6-mujore dhe vjetore të Urdhrit të Agronomëve pranë MBZHR-së;
- administrimit dhe përditësimit të regjistrit profesional dhe regjistrit të posaçëm për profesione të ngjashme;
- monitorimit të veprimtarisë së organeve drejtuese dhe komisioneve disiplinore;
- bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat inspektuese për verifikimin e ushtrimit të profesionit në përputhje me ligjin;
- vlerësimit të përdorimit dhe eficiencës së financimit shtetëror gjatë periudhës tranzitore.

Kriteret dhe treguesit për matjen e arritjes së qëllimeve dhe progresit

Për matjen e arritjes së qëllimeve të projektligjit dhe progresit drejt tyre, përdoren tregues specifikë, të matshëm, të arritshëm, relevantë dhe të përcaktuar në kohë (SMART), si vijon:

1. numri i agronomëve të regjistruar dhe të licencuar në Urdhrin e Agronomëve;
2. numri i profesioneve të ngjashme të regjistruara dhe të certifikuara në regjistrin e posaçëm;
3. niveli i mbulimit territorial të strukturave rajonale të Urdhrit;
4. numri i masave disiplinore të shqyrtuara dhe i vendimeve përfundimtare;
5. koha mesatare e përpunimit të kërkesave për regjistrim dhe licencim;
6. numri i aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të organizuara çdo vit;
7. niveli i funksionimit të mekanizmave të bashkëpunimit institucional me MBZHR-në dhe strukturat inspektuese përmes evidencave të takimeve të kryera për këtë qëllim, emaillet, bashkëpunimet e ndryshme në fusha të përbashkëta, akte ligjore/nënligjore të fushave të përbashkëta etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës	<u>1</u>	<u>0.95</u> <u>2835</u>	<u>0.907</u> <u>894</u>	<u>0.86</u> <u>5073</u>	<u>0.824</u> <u>271</u>	<u>0.785</u> <u>394</u>	<u>0.748</u> <u>351</u>	<u>0.713</u> <u>055</u>	<u>0.679</u> <u>423</u>	<u>0.6473</u> <u>78</u>
Kosto për buxhetin – njëherë	10.27	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto përbuxhetin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto përbiznesin – në vazhdim	0.00	8.12 590	8.125 90	8.12 590	8.125 90	8.125 90	8.125 90	8.125 90	8.125 90	8.1259 0

Kosto për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	10.270 9	8.12 59	8.125 9	8.12 59	8.125 9	8.125 9	8.125 9	8.125 9	8.125 9	8.1259
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	10.270 9	7.74 26	7.377 5	7.02 95	6.697 9	6.382 0	6.081 0	5.794 2	5.520 9	5.2605
Përfitimipërbuxhetin – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimipërbiznesin – njëherë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimipërbiznesin – në vazhdim	8.88	3.63	3.63	3.63	8.88	3.63	3.63	3.63	3.63	8.88
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Kosto për buxhetin – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi në total	8.88	3.63	3.63	3.63	8.88	3.63	3.63	3.63	3.63	8.88
Përfitimi i zbritur në total = Përfitim në total x faktorin zbritës	8.88	3.46	3.29	3.14	7.32	2.85	2.72	2.59	2.46	5.75
Vlera aktuale e kostos në total	68.16 lekë									
Vlera aktuale e përfitimit në total	42.45 lekë									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-25.71 lekë									

Projektligji “Për Urdhrin e Agronomit në Republikën e Shqipërisë” parashikon efekte financiare që lidhen me ngritjen, organizimin dhe funksionimin fillestar të Urdhrit të Agronomit. Urdhri parashikohet të funksionojë si ent publik jobuxhetor, me buxhet të vetin dhe me burime financimi nga kuotat e anëtarësimit, tarifat e regjistrimit dhe të lejeve profesionale, tarifat për shërbime, trajnimet, donacionet dhe të ardhurat e tjera të ligjshme. Mbështetja nga Buxheti i Shtetit parashikohet të ketë karakter të përkohshëm (1 vit) dhe të kufizohet në fazën fillestare të ngritjes dhe funksionalizimit të Urdhrit. Kjo mbështetje nuk përbën shpenzim të veçantë nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila do të ushtrojë funksionet e koordinimit dhe monitorimit nëpërmjet strukturave ekzistuese dhe brenda fondeve të miratuara.

Vlerat e paraqitura në këtë analizë kanë karakter hipotetik, orientues dhe të rishikueshëm. Përllogaritja e kostove është realizuar duke marrë si model referues kostot fillestare dhe shpenzimet e funksionimit të miratuara për Këshillin Veterinar Shqiptar, të përshtatura për një strukturë minimale të Urdhrit të Agronomit. Në të njëjtën mënyrë, përllogaritja e të

ardhurave është mbështetur në kuotat dhe tarifat e aplikuara nga Këshilli Veterinar Shqiptar për mjekët veterinerë.

Për qëllime të analizës është marrë në konsideratë një numër prej rreth 350 anëtarësh potencialë, bazuar në numrin e evidentuar të punonjësve me profil agronom në institucionet publike të sektorit të bujqësisë në MBZHR. Ky numër nuk përfaqëson numrin përfundimtar të anëtarëve të Urdhrit, pasi mund të ndryshojë pas përfshirjes së agronomëve që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin privat dhe të personave që ushtrojnë profesione të lidhura me agronominë. Projektligji nuk përcakton në mënyrë shteruese kategoritë e këtyre profesioneve, por në to mund të përfshihen specialistë të prodhimit bimor, mbrojtjes së bimëve, këshillimit bujqësor, menaxhimit të tokës, farave dhe fidanëve, materialeve mbjellëse, plehrave, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe inputeve të tjera bujqësore.

Kostot fillestare për ngritjen dhe funksionalizimin e Urdhrit janë përlogaritur në shumën 2,145,000 lekë, si më poshtë:

Nr.	Zëri i kostos fillestare	Përshkrimi	Vlera e parashikuar, lekë
1	Mobilim zyre	Mobilim minimal për funksionimin e një zyre të vogël, përfshirë tavolina, karrige, dollapë dhe pajisje bazë pune	500,000
2	Pajisje IT dhe zyre	Kompjuterë, printer/skaner, pajisje rrjeti dhe pajisje të tjera bazë për administrimin e punës	700,000
3	Program financiar/kontabiliteti	Program ose shërbim bazë për administrimin financiar dhe kontabël	100,000
4	Organizimi i komisionit të përkohshëm dhe zgjedhjeve të para	Shpenzime për materiale, komunikim, mbështetje administrative dhe organizimin e procesit fillestar zgjedhor	500,000
5	Informim fillestar dhe komunikim publik	Njoftime, materiale informuese dhe komunikim me profesionistët që do të regjistrohen	150,000
	Nën-total kosto fillestare		1,950,000
6	Kontingjencë për shpenzime të paparashikuara	Rreth 10% e kostove fillestare	195,000
Totali i kostove fillestare			2,145,000

Në këtë vlerë përfshihen 500,000 lekë për mobilimin minimal të zyrës, 700,000 lekë për pajisje IT dhe pajisje të tjera zyre, 100,000 lekë për programin financiar dhe të kontabilitetit, 500,000 lekë për organizimin e Komisionit të Përkohshëm dhe zgjedhjeve të para, 150,000 lekë për informimin fillestar dhe komunikimin publik, si dhe 195,000 lekë kontingjencë për shpenzime të paparashikuara. Baza e të dhënave që parashikon nenin 2, gërma “a” është në përputhje me parashikimet e nenit 2, pika 2, të ligjit nr. 10 325/2010 i cili citon “Bazat e të dhënave shtetërore, që krijohen për të plotësuar vetëm kërkesat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit publik, nuk i nënshtrohen këtij ligji”. Pra, ky

rregjistër është në një format të thjeshtë elektronik, për qëllim të funksionimit të brendshëm të Urdhërit të Agronomit.

Sa i përket kostove të vazhdueshme, për funksionimin minimal të Urdhrit është përlogaritur një kosto vjetore hipotetike prej 8,125,900 lekësh, si më poshtë:

Nr.	Zëri i shpenzimit	Përshkrimi	Vlera vjetore, lekë
1	Shpenzime personeli	Struktura organizative dhe organika e Urdhrit do të miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar, me propozim të Presidentit të Urdhrit. *Kjo përlogaritje është hipotetike*	5,700,000
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Përlogaritje mbi pagat	951,900
	Nën-total personeli		6,651,900
3	Qira zyre	50,000 lekë × 12 muaj	600,000
4	Energji, ujë, ngrohje/ftohje	Shpenzime minimale mujore	150,000
5	Internet, telefon, postë	Shpenzime minimale	80,000
6	Kancelari dhe materiale konsumi	Shpenzime bazë	100,000
7	Pastrim/mirëmbajtje zyre	Shpenzime minimale	100,000
8	Udhëtime brenda vendit	Lëvizje të kufizuara	344,000
9	Takime, trajnime dhe informim	Aktivitete të kufizuara	100,000
	Nën-total kosto të vazhdueshme vjetore		1,474,000
10	Kontigjencë rreth 10%	Shpenzime të paparashikuara	147,400
	Totali i kostove të vazhdueshme vjetore		8,125,900

Në këtë shumë përfshihen shpenzimet e personelit 5,700,000 për paga dhe 951,900 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në këtë mënyrë, kostot vjetore të personelit përlogariten në shumën 6,651,900 lekë. Theksojmë se kjo përlogaritje është hipotetike pasi Struktura organizative dhe organika e Urdhrit do të miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar, me propozim të Presidentit të Urdhrit. Vlera e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe e shpenzimeve për paga ka karakter orientues dhe do të rillogaritet në përputhje me nivelin përfundimtar të pagave bruto dhe normat ligjore në fuqi.

Shpenzimet e tjera operative vjetore përlogariten në shumën 1,474,000 lekë dhe përfshijnë 600,000 lekë për qiranë e zyrës, 150,000 lekë për energjinë, ujin dhe ngrohjen ose ftohjen, 80,000 lekë për internetin, telefonin dhe shërbimet postare, 100,000 lekë për kancelari dhe

materiale konsumi, 100,000 lekë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e zyrës, 344,000 lekë për udhëtime brenda vendit dhe 100,000 lekë për takime, trajnime dhe veprimtari informuese. Për shpenzime të paparashikuara është parashikuar një kontingjencë prej 147,400 lekësh. Bazuar në këto përlllogaritje, nevoja financiare bruto për vitin e parë vlerësohet në shumën 10,270,900 lekë, nga të cilat 2,145,000 lekë përfaqësojnë kostot fillestare të ngritjes dhe organizimit të Urdhrit, ndërsa 8,125,900 lekë përfaqësojnë shpenzimet e vazhdueshme vjetore. Mbështetja nga Buxheti i Shtetit do të synojë garantimin e ngritjes dhe të likuiditetit fillestar të Urdhrit, deri në fillimin dhe konsolidimin e të ardhurave të veta. Masa faktike e financimit publik mund të jetë më e ulët se kostoja bruto e parashikuar, në varësi të momentit të fillimit të veprimtarisë, ritmit të regjistrimit të anëtarëve dhe nivelit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit të parë.

Sa i përket të ardhurave të mundshme të Urdhrit të Agronomit, në këtë fazë nuk është e mundur të bëhet një përlllogaritje e saktë, pasi niveli i kuotizacioneve, tarifave të regjistrimit, lejeve profesionale, tarifave për shërbime apo pagesave të tjera do të përcaktohet me vendim të organeve drejtuese të Urdhrit të Agronomit, pas krijimit dhe funksionalizimit të tij. Në çdo rast, duke qenë se Urdhri parashikohet të funksionojë si ent publik jobuxhetor, shpenzimet e vazhdueshme të viteve pasuese do të planifikohen dhe realizohen në raport të drejtë me të ardhurat e krijuara nga vetë Urdhri, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe shmangien e krijimit të detyrimeve shtesë për buxhetin e shtetit.

Më poshtë paraqitet një version hipotetik i të ardhurave të gjeneruara nga tarifat e regjistrimit, lejet, apo kuota të tjera.

Përlllogaritja e të ardhurave është realizuar duke marrë si referencë tarifat e aplikuara nga Këshilli Veterinar Shqiptar:

Lloji i të ardhurës	Tarifa orientuese
Kuota e anëtarësimit	500 lekë në muaj
Leja profesionale	15,000 lekë
Njohja e një krediti profesional	500 lekë për kredit
Vërtetim për përdorim brenda vendit	500 lekë
Vërtetim për përdorim jashtë vendit	1,000 lekë
Pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga Urdhri	2,000 lekë për pjesëmarrës

Për qëllime të analizës, llojet e të ardhurave dhe tarifat janë marrë drejtpërdrejt nga modeli i Këshillit Veterinar Shqiptar. Gjithashtu, edhe për lejet profesionale janë planifikuar të rinovohen çdo 5 vite. Ky afat është përdorur si referencë për përlllogaritjen hipotetike të të ardhurave të Urdhrit të Agronomit, ndërkohë që periodiciteti përfundimtar për këtë të fundit do të përcaktohet në aktet dhe rregulloret përkatëse. Gjithashtu, tarifa për njohjen e krediteve profesionale është përlllogaritur për kreditë e përfituara në aktivitete të organizuara nga subjekte të tjera. Për trajnimet e organizuara drejtpërdrejt nga Urdhri, tarifa e pjesëmarrjes mund të përfshijë edhe njohjen e krediteve, me qëllim shmangien e tarifimit të dyfishtë.

Tarifa për njohjen e krediteve profesionale është përlllogaritur për kreditet e përfituara në aktivitete të organizuara nga subjekte të tjera. Për trajnimet e organizuara drejtpërdrejt nga

Urdhri, tarifa e pjesëmarrjes mund të përfshijë edhe njohjen e krediteve, duke shmangur tarifimin e dyfishtë.

Për efekt të analizës janë përdorur këto supozime:

- 350 anëtarë;
- 5 kredite profesionale mesatarisht për çdo anëtar;
- 70 vërtetime për përdorim brenda vendit;
- 18 vërtetime për përdorim jashtë vendit;
- 3 trajnime në vit, me nga 100 pjesëmarrës.

Burimi i të ardhurave	Përlllogaritja	Vlera
Kuota e anëtarësimit	$350 \times 500 \times 12$ muaj	2,100,000 lekë
Lejet profesionale	$350 \times 15,000$	5,250,000 lekë
Njohja e krediteve profesionale	$350 \times 5 \times 500$	875,000 lekë
Vërtetime brenda vendit	70×500	35,000 lekë
Vërtetime jashtë vendit	$18 \times 1,000$	18,000 lekë
Trajnime të organizuara nga Urdhri	$3 \times 100 \times 2,000$	600,000 lekë
Totali i të ardhurave të mundshme		8,878,000 lekë

Bazuar në skenarin hipotetik të mësipërm, kostot fillestare për ngritjen e Urdhrit të Agronomit vlerësohen në **2,145,000 lekë**, ndërsa shpenzimet vjetore të funksionimit në **8,039,900 lekë**. Kostoja e përgjithshme e vitit të parë përlllogaritet në **10,184,900 lekë**.

Për një numër prej 350 anëtarësh (vetëm nga Ministria e Bujqësisë), të ardhurat e vitit të parë nga kuotat, lejet profesionale, kreditë, vërtetimet dhe trajnimet vlerësohen në **8,878,000 lekë**, (1 herë në 5 vite), ndërsa në vitet në vijim do të jetë **3,628,000 lekë**

Përlllogaritjet tregojnë se Urdhri mund të ketë potencial për të mbuluar kostot e funksionimit nga të ardhurat e veta dhe për të kaluar në vetëfinancim pas periudhës fillestare. Mbështetja nga Buxheti i Shtetit do të ketë karakter të përkohshëm dhe masa faktike e saj do të varet nga ecuria e regjistrimit, realizimi i të ardhurave dhe nevojat për likuiditet gjatë vitit të parë.

Të gjitha vlerat janë **hipotetike, orientuese dhe të rishikueshme**. Kostot dhe të ardhurat përfundimtare do të përcaktohen pas evidentimit të numrit faktik të anëtarëve (në sektorin provat dhe publik), miratimit të strukturës organizative, përcaktimit të afatit të vlefshmërisë së lejes profesionale dhe miratimit të kuotave e tarifave nga organet kompetente të Urdhrit të Agronomit.

Për një numër prej 350 anëtarësh (vetëm nga Ministria e Bujqësisë), të ardhurat e vitit të parë nga kuotat, lejet profesionale, kreditë, vërtetimet dhe trajnimet vlerësohen në **8,878,000 lekë**, (1 herë në 5 vite), ndërsa në vitet në vijim do të jetë **3,628,000 lekë**

Përlllogaritjet tregojnë se Urdhri mund të ketë potencial për të mbuluar kostot e funksionimit nga të ardhurat e veta dhe për të kaluar në vetëfinancim pas periudhës fillestare. Mbështetja

nga Buxheti i Shtetit do të ketë karakter të përkohshëm dhe masa faktike e saj do të varet nga ecuria e regjistrimit, realizimi i të ardhurave dhe nevojat për likuiditet gjatë vitit të parë.

Të gjitha vlerat janë **hipotetike, orientuese dhe të rishikueshme**. Kostot dhe të ardhurat përfundimtare do të përcaktohen pas evidentimit të numrit faktik të anëtarëve (në sektorin provat dhe publik), miratimit të strukturës organizative, përcaktimit të afatit të vlefshmërisë së lejes profesionale dhe miratimit të kuotave e tarifave nga organet kompetente të Urdhrit të Agronomit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionëlekë		Vlera aktuale neto në milionëlekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni i zgjedhur	68.56	48.38	-20.18

Për opsionin e zgjedhur, vlera aktuale e kostove të përlogaritura për periudhën e analizës është **68.56 milionë lekë**, ndërsa vlera aktuale e përfitimeve të monetarizuara është **48.38 milionë lekë**. Për rrjedhojë, vlera aktuale neto rezulton **-20.18 milionë lekë**, çka tregon se kostot e monetarizuara tejkalojnë përfitimet e monetarizuara me këtë shumë.

Rezultati negativ nuk nënkupton domosdoshmërisht se opsioni i zgjedhur nuk është i justifikuar. Një pjesë e konsiderueshme e përfitimeve të projektligjit, si formalizimi dhe mbrojtja e profesionit, rritja e cilësisë së shërbimeve agronomike, forcimi i përgjegjshmërisë profesionale, përmirësimi i këshillimit ndaj fermerëve, sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së mjedisit, nuk mund të maten plotësisht në terma monetarë. Për rrjedhojë, vlerësimi përfundimtar i opsionit duhet të marrë në konsideratë jo vetëm vlerën aktuale neto financiare, por edhe përfitimet institucionale, sociale, ekonomike dhe mjedisore të pritshme.

Krijimi dhe funksionimi i Urdhrit të Agronomit synon të vendosë një mekanizëm të qëndrueshëm rregullimi, regjistrimi, mbikëqyrjeje dhe disiplinimi për ushtrimin e profesionit të agronomit dhe profesioneve të lidhura me të. Përfitimet kryesore nuk shfaqen në formën e të ardhurave të menjëhershme financiare për buxhetin e shtetit, por në formën e rritjes së cilësisë së shërbimeve agronomike, forcimit të përgjegjshmërisë profesionale, mbrojtjes së fermerëve dhe konsumatorëve, përmirësimit të standardeve teknike në përdorimin e inputeve bujqësore dhe mbrojtjes së bimëve, si dhe rritjes së sigurisë ushqimore dhe qëndrueshmërisë së prodhimit bujqësor.

Për rrjedhojë, edhe pse vlera aktuale neto rezulton negative në terma financiarë, opsioni i zgjedhur justifikohet nga përfitimet jofinanciare dhe afatgjata që pritët të krijojë. Këto përfitime lidhen me stabilitetin institucional, formalizimin e ushtrimit të profesionit, krijimin e një regjistri të qartë profesional, rritjen e transparencës, përmirësimin e kontrollit profesional dhe forcimin e besimit të publikut në shërbimet agronomike.

Në këtë kuptim, kostoja e parashikuar konsiderohet si investim fillestar për ngritjen e një strukture rregullatore profesionale, e cila pritët të sjellë ndikim pozitiv në funksionimin e sektorit bujqësor, në cilësinë e këshillimit teknik dhe në mbrojtjen e interesit publik.